

Struktura për zgjedhje prej më shumë mundësive

Kjo strukturë bna mundëson të zgjedhim prej tre e më tepër alternativave.

Egzistojnë dy lloje kryesore kësaj strukture. Ato janë:

a) Struktura e shumëfishtë (if-else if -else)

b) Struktura case switch

Struktura për zgjedhje të shumëfishtë

Me strukturën if-else if përveç që mund të zgjedhim prej dy mundësive këtu kemi alternativë për të zgjedhur prej 3 e më tepër mundësive.

Forma e përgjithshme e kësaj strukture është si në vazhdim:

```
if(kushti)
{
shprehje1;
}
else if(kushti 2)
{shprehja 2;
}
else if(kushti3)
{ shprehja 3;
}
:
:
else if(kushtin n)
{ shprehja n;
}
```

Në vazhdim do të demonstroj me një shembull

Shembull

Të shënohet një program i cili do të mundëson që të shënon një numër prej 1 deri në 5 psh nëse numri është 1 na jep si dalje numri është 1 nëse numri 2 të na jep si dalje numri është 2 e kështu me rradhë.

```
#include <iostream>
using namespace std;
int main()
{
    int numer;
    cout << "Shënoni nje numer prej 1 deri ne 5!"<<endl;
    cin>>numer;
    if(numer==1)
    {
        cout<<"Numri eshte 1";
    }
    else if(numer==2)
    {
        cout<<"Numri eshte 2";
    }
    else if(numer==3)
    {
        cout<<"Numri eshte 3";
    }
    else if(numer==4)
    {
        cout<<"Numri eshte 4";
    }
    else if(numer==5)
    {
        cout<<"numri eshte 5";
    }
    return 0;
}
```

Dalje

```
Shenoni nje numer prej 1 deri ne 5!  
1  
Numri eshte 1
```

Struktura switch case

Kjo struktura gjithashtu mundëson zgjedhje prej më shumë mundësive. Dalja e kesaj strukture mvaret nga kushti i shënuar në switch komandën. Për dallim nga struktura if ele if else

```
switch (kushti)  
{  
case 0: shprehja;  
break;  
case 1: shprehja1;  
break;  
.....  
case n: shprehjan;  
}
```

Shembulli më poshtë demonstroi përdorimin e kësaj strukture

Shembull

Të shënohet një program i cili do të mundëson që të shënon një numër prej 1 deri në 5 psh nëse numri është 1 na jep si dalje numri është 1 nëse numri 2 të na jep si dalje numri është 2 e kështu me rradhë.

```
1 #include <iostream>  
2 using namespace std;  
3  
4 int main() {  
5     int numer = 4;  
6     switch (numer) {  
7         case 1:  
8             cout << "Numri eshte 1";  
9             break;  
10        case 2:  
11            cout << "Numri eshte 2";  
12            break;  
13        case 3:  
14            cout << "Numri eshte 3";  
15            break;  
16        case 4:  
17            cout << "Numri eshte 4";  
18            break;  
19        case 5:  
20            cout << "Numri eshte 5";  
21            break;  
22    }  
23    return 0;  
24 }  
25  
26
```

Dalje

```
Numri eshte 4
```

Dallimi mes strukture if else if else dhe case switch

1. Te struktura if-else if -else kushti mbrenda komandës if vendos nëse do të ekzekutojë shprehjet brenda if bllokut ose mbrenda else bllokut. Ndërsa te struktura switch, kushti mbrenda komandës switch vendos se cili rast të ekzekutohet.

2. Te degëzimi i shumëfshtë kushtet janë shprehje logjike, ndërsa te struktura case switch kushti është shprehje vlera e të cilit patjetër të jetë ndonjë konstante, numër i plotë ose shenjë.

Detyra dhe ushtrime

1. Në cilat raste zbatohet struktura për zgjedhje prej më shumë mundësive?

2. Cilat dy lloje të strukturës për zgjedhje egistojnë?

3. Çka do të tregohet te ekranin pas realizimit të këtyre komandave për $x = 3$?

```
int x;
```

```
cin>>x;
```

```
if(x == 1)
```

```
cout<<"Dobët! "«endl;
```

```
else if(x == 2)
```

```
cout<<"Nuk është keq! "«endl;
```

```
else if(x == 3)
```

```
cout<<"Bravo! "«endl;
```

```
else
```

```
cout<<"Keni futur numer te gabuar! "«endl;
```

3. Shkruaj program me të cilën konsumatori do të futë numër rendor të ditës së javës dhe në ekran do të shtypet emri i ditës përkatëse! Në rastin e të dhënës hyrëse jo përkatëse të tregohet porosia përkatëse.

Shembulli 1:

Fut numër rendor të ditës së javës: 5

Sot është e premte!

Shembulli 2:

Fut numër rendor të ditës së javës: 9

E dhënë e gabuar!

Vërejteje: Ky dokument është për tre njësi mësimore. Për datat 23,24 dhe 30 mars 2020. Për çdo paqartësi ju lutem më kontaktoni në email adresën lirie_memeti@hotmail.com